



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI

VENDIM

Nr. 272, Datë 19.09.2023

MBI
RINOVIMIN E LICENCËS SË SHOQËRISË “AYEN ENERGY TRADING” SH.A.,
NË VEPRIMTARINË E FURNIZIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të neneve 16 dhe 37, pika 2, gërma “ç”, të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; neneve 4, pika 1, gërma “d”, 5, pika 1, gërma “d”, 13 dhe 16 të Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike, të miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.06.2016, e ndryshuar; si dhe nenit 15 të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.06.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 19.09.2023, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 2045/5 prot., datë 14.09.2023, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, “Mbi rinovimin e licencës së shoqërisë “AYEN ENERGY TRADING” sha, në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike” ,

Konstatoi se:

- Shoqëria “AYEN ENERGY TRADING” sh.a., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 2045 prot., datë 21.08.2023, paraqiti aplikimin për rinovimin e licencës në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike dhe me vendimin nr. 264, datë 31.08.2023, bordi i ERE-s vendosi të fillojë procedurën për kërkesën e protokolluar në ERE.
- ERE botoi njoftimin në median e shkruar për fillimin e kësaj procedure (në datat 01.09.2023 dhe 02.09.2023) dhe në përfundim të afatit të pritjes së komenteve apo objeksioneve nga të tretët (data 10.09.2023), nuk rezultoi të ketë të tilla. Ky njoftim u publikua dhe në faqen zyrtare të internetit të ERE-s.
- Me shkresën nr. 2045/3 prot., datë 07.09.2023, ERE iu drejtua shoqërisë duke i njoftuar vendimin për fillimin e procedurës dhe njoftimin për të plotësuar detyrimin për sa i përket pagesës së rregullimit të vitit 2023, për të cilën ky subjekt rezulton debitor.

- Shoqëria ka kryer pagesën e aplikimit në zbatim të përcaktimeve të Aneksit A të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licensave në sektorin e energjisë elektrike” e ndryshuar, si dhe ka shlyer ndaj ERE-s të gjitha detyrimet për sa i përket pagesave të rregullimit.
- Dokumentacioni i këtij aplikimi rezulton tërësisht i plotësuar.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Të rinovojë licencën e shoqërisë “AYEN ENERGY TRADING” sh.a. në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike për një afat 5-vjeçar duke filluar nga data 16.03.2024.
2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, të njoftojë aplikuesin për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare

KRYETARI

Petrit AHMETI